



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 151, Datë 18.09.2020

MBI

**ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K., NR. 306, SERIA FK15, PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S, NR. 105, DATË 18.08.2015.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 8, nenit 9, nenit 13, si dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.09.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/2 Prot, datë 07.09.2020, e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 134, datë 10.08.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/22 Prot, datë 11.08.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 947/1 Prot, datë 13.08.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. me shkresën nr. 31 Prot, datë 20.08.2020, protokolluar në ERE me nr. 974/2, datë 21.08.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar me përjashtim të Sistemit IT dhe Disponimit të zyrave të dedikuara për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 974/3 Prot, datë 28.08.2020, në bazë të nenit 11 të Rregullores së licencimit iu kërkua shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj edhe nga rrethi i Përmetit.
- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 974/4 Prot, datë 01.09.2020 dhe shkresës nr. 974/5 Prot, datë 03.09.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Në vijim të situatës të krijuar nga COVID-19, në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 133, datë 10.08.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 51, datë 26.03.2020 “*Mbi disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë*”, është përcaktuar se afati për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence për të gjitha licencat që kanë përfunduar deri në 30 qershor 2020, është jo më vonë se data 01.09.2020.
- Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. rezultoi i paraqitur në afat.
- Rezulton se shoqëria ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim** (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni teknik për veprimtarine e furnizimit të energjise elektrike** (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas gërmës “e” (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).

Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas gërmës “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve).
- Referuar dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe informacionit të përcjellë për qëllime të këtij aplikimi rezultoi e paqartë se si do të sigurohet energjia për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit nga shoqëria aplikuese.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes së ERE mbi kërkesën e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI